REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

---

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 7 të Ligjit nr. 04/ L-076 për Policinë, nenit 9 paragrafi 1.7. Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi, si dhe neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës______2022 të miratojë këtë

**PROPOZIM**

VENDIM
PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PUNËS SË KKSB-së PËR VITIN 2022

**Neni 1**

**MIRATOHET** , Plani vjetor i punës së KKSB –së –Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2022.

**Neni 2**

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani vjetor i punës së KKSB për vitin 2022.

**Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës .

**Arsyetim**

Baza ligjore për miratuar këtë Propozim - Vendim është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 7 të Ligjit nr. 04/ L-076 për Policinë, nenit 9 paragrafi 1.7. Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi, si dhe neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021
Duke vepruar në bazë të Udhëzimit administrativ 27/2012 të MPB përkatësisht 03/2012 të MAPL, Kuvendi Komunal i Lipjanit në mbledhjen e datës 31. 01. 2022 përveç tjerash ka

themeluar edhe Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi. Sipas rregullit Kryesuesi i kuvendit ka nxjerrë Vendimin për emërim të cilin ua ka dërguar të emëruarve, ministrive përkatëse dhe e ka publikuar në Web faqen zyrtare të Komunës.
Kryetari i komunës,-Kryesuesi i KKSB ka thirrur dhe ka mbajtur mbledhjen e parë të rregullt –konstituive me datën 10. 03. 2022 dhe në takimin e dytë të dt 06. 05. 2022 përveç pikave tjera të rendit të ditës, KKSB ka diskutuar dhe aprovuar Propozim Planin Vjetor të Punës së KKSB për vitin 2022 .
Në pajtim me dispozitat e cekura ligjore, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 011 – 24807
Lipjan, Më 17. 05

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti
për [signature]

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi ( KKSB)

# PLANI
# VJETOR I VEPRIMIT TË KKSB PËR VITIN 2022

| Nr | Aktiviteti – Detyra | Afati i kryerjes | Bartësi i aktivitetit | Bashkëpunëtorët | Kostoja financiare | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Rritja e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve ,parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal | Vazhdimisht | Kryesuesi i KKSB | Anëtarët tjerë të KKSB | | |
| 2 | Ngritja e vetëdijes të qytetarëve të komunës së Lipjanit për rrezikun ndaj zjarrit sidomos për periudhën e korrje – shirjeve. | 05- 25. 06. 2022 | Kryesuesi i **KKSB** | K-danti i NJPZSh, drejtori i DShP MSH, Stacioni Policor dhe 2 nënstacionet | 3250 euro (dalja ne terren, ligjëruesit aparatet KZ,materil shpenzues-ilustrues etj. | EVSB |
| 3 | Gjetja e një zgjidhjeje | Vazhdimisht | - | DBP, PK | | EVSB |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | të pranueshme për trajtimin e qenve endacak | | | | | |
| 4 | Plotësimi dhe azhurnimi i portalit " Së bashku për siguri" i cili është dizajnuar nga OSCE në bashkëpunim me PK e MPB | rregullisht | Anëtarët e KKSB | EVSB,KLSP,PK institucionet e pushtetit lokal | | |
| 5 | Identifikimi i brengave të qytetarëve lidhur me sigurinë publike | 25. 07. 2022 | Anëtarët e KKSB | Komuniteti EVSB | | EVSB, KLSP |
| 6 | Shtrirja dhe fuqizimi i programit" Vrojtuesi i lagjes" i iniciuar nga ICITAP | 30. 06. 2022 | EVSB, PK, EVSB | Qytetarët, ShC. | | EVSB |
| 7 | Studimi i Strategjisë dhe Planit të veprimit për parandalimin e EDhRShT | 25.07. 2022 | KKSB | Subjektet sipas Startegjisë dhe PV të QRK | | QRK |
| 8 | Përpilimi i planit për zvogëlimin e brengave-kërcënimeve të identifikuara nga qytetarët e lokaliteteve të ndryshme. | 30. 06. 2022 | Kryesuesi i KKSB, Shefi i Policisë, DMSh | Varësisht nga lloji i kërcënimit | | |
| 9 | Implementimi i Planit për veprim në bashkësi - komunitetin konkret . | 30. 07. 2022 | Varësisht nga lloji i kërcënimit | KKSB | | |
| 1o | Thirrja dhe mbajtja e | Së paku 6 | Kryesuesi- | Anëtarët e | | Si dhe |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | takimeve të rregullta të KKSB | takime brenda vitit kalendarik | stafi Ndihmës | KKSB | | në raste emergjencash |
| 11 | Ndërtimi i besimit në mes të policisë dhe qytetarëve | Çdo ditë | Shefi i policisë | Anëtarët e KKSB | | Të hartohet Plan i posaçëm |
| 12 | Ndërtimi i besimit në mes të komuniteteve etnike dhe mes bashkësive fetare | Çdo ditë | Liderët e komuniteteve , udhëheqësit e bashkësive fetare | Anëtarët e KKSB | | Punë ekipore në terren |
| 13 | Organizimi i takimeve të përbashkëta me forumet e sigurisë ( KKSB,EVSB KLSP)të komunave fqinje. | Dy herë në vit | Kryesuesi i KKSB , Koordinatori | Kryesuesit e komunave fqinje | | |
| 14 | Bashkëpunimi me KLSP dhe EVSK për të mbështetur policinë në planifikimin dhe zbatimin e fushatave të vetëdijesimit për siguri në bashkësi. | | Kryesuesi i KKSB | Anëtarët e KKSB dhe KLSP, EVSK | | |
| 15 | Hartimi i procesverbaleve për mbledhjet dhe dërgimi i tyre MPB, MAPL | Pas çdo mbledhjeje | Sekretaria e KSSB ( shërbimi i KKL). | Sektori per punë të KKL | | Kopjet u dërgohen edhe anëtarëve të |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | KKSB |
| 16 | Organizimi dhe mbajtja e takimeve të KKSB me qytetar . | Çdo 6 muaj | Kryesuesi i KKSB, anëtarët tjerë | Institucionet e përfaqësuara në KKSB | | |
| 17 | Hartimi i Raportit të punës së KKSB për Kuvendin e komunës mbi diskutimet ,vendimet dhe rezultatet e KKSB | Sipas Udhëzimit Administrativ të MPB-MAPL | Kryesuesi, Koordinatori | Procesmbajtësi dhe anëtarët që kanë para-qitur material të shkruar | | |
| 18 | Shtrirja e mëtejme dhe forcimi i bashkëpunimit të forumeve të sigurisë me institucionet e sigurisë | Me marrëveshje te përbashkët | Kryesuesi | Anëtarët e KKSB | | Nëse ka gatish-mëri |
| 19 | Inicimi dhe implementimi i fushatave -aksioneve te përbashkëta sensibilizuese dhe edukative në lokalitetet periferike dhe specifike | Kurdo që shihet e arsyeshme | Të gjithë të interesuarit | Anëtarët e KKSB | Sipas projektit konkret të propozuar dhe aprovuar në KKSB, KKL apo donator eventual | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 20 | Trajnimi fillestar për anëtarët e rinjë të KKSB të cilët marrin këtë detyrë për herë të parë. | | Kryesuesi | MPB, OSBE, MAPL | | |
| 21 | Aktivitete senzibilizuese per shënimin e vitit 2022 si vit i personave me aftësi të kufizuara | Të akordohet me agjendën e nivelit qendror (QRK) | Kryesuesi | Anëtarët, PK, OJQ, mediat | Për materialet sensibilizuese një kosto simbolike | |
| 22 | Radikalizimi dhe ekstremizmi fetar | Maj - qershor | Kryesuesi | KBI, PK, OJQ | 50 euro | |
| 23 | Vetëdijësimi i nxënësve për rrezikun që paraqesin dukuritë negative (narkotikët,prostitucioni, terrorizmi, alkooholi, duhani, bixhozi etj) | Maj- shtator | Kryesuesi | KBI, DKA, DShMS, PK, OJQ | 200 euro | |
| 24 | Toleranca ndërfetare | Gusht | KBI | Bashkësitë fetare | 50 euro | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 25 | Siguria në shkolla | Shtator | Kryesuesi | DKA, PK | 150 euro | |
| 26 | Siguria e nxënësve dhe e maturantëve me rastin e organizimeve të ekskurzioneve dhe mbrëmjes së maturës. | Në prag të këtyre organizimive | Kryesuesi | Këshilli i prindërve, drejtorët e shkollave, DKA, PK, KBI, OJQ. | 180 euro | |
| 27 | Fushatë për parandalimin e zjarreve fushore e malore | Korrik – gusht | Kryesuesi | PK, Zjarrfikësit, drejtoria për bujqësi e pylltari, Inspektorati. | 80 euro | |
| 28 | Fushatë vetëdijësuese kundër dhunës në familje | Nëntor- dhjetor | KBI, zyra për barazi gjinore | DKA. PK, QPS | 100 euro | |
| 29 | Kujdesi në trafik | Korrik | Kryesuesi | PK, DShP/ MSh | 130 euro | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 30 | Edukimi medial dhe siguria në internet | Nëntor | KBI | DKA, OSBE, OJQ | 80 euro | |
| 31 | Aktivitete për rritjen e nivelit të sigurisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, | Tetor | Kryesuesi,Zj arrfikësit | DShP/MSh | 300 euro | |
| 32 | Të sigurohen kushte më të mira për punë të pa penguar për zjarrfikësit e NjPZSh Lipjan | Sa më parë | Kryesuesi | Institucionet e pushtetit lokal dhe qendror( AME/MPB) | | |
| 33 | Vendosja e sinjalizimit vertikel me shenja përkatëse pranë vend kalimeve të këmbësorëve( zebra) për shkak të fshirjes së tyre të shpejtë nga asfalti. | Sa më parë | Kryesuesi | DShP/MSh PK, ndërmarrja punëkryese | | |
| 34 | Mirëmbajtja më e rregullt e llampave të ndriqimit publik në rrugët e qytetit | Rregullisht | Operatori i kontraktuar | DShP/MSh, PK, Inspektorati | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 35 | Angazhimi i punëtorëve/zjarrfikës sezonal për fikjen e zjarreve në Janjevë me rrethinë | Korrik-shtator | Kryetari i komunës | DShP/MSh, KLSP Janjevë | 6000 euro për tre muaj | Trajnimi bazik 2 javor në Vushtrri në qershor |

**Kryesuesi i KKSB**
**Imri Ahmeti**

për: [signature]